

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Asgjësimi duhet të realizohet me një prej metodave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore të përcaktuara ne VKM nr 798 date 29.09.2010.

2. Mbetjet do të merren nga sipërmarrësi pranë ambientit të shërbimit që do të vendoset nga Autoriteti Kontraktor , me automjetet e tij të posaçëm/qira, lehtësisht te identifikushem gjate transportit te mbetjeve me shenjen dalluese nderkombetare te rrezikut te mbetjeve te rrezikshme spitalore ne perputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcen nr.4 te VKM – se Nr.798 dt.29.09.2010 dhe sipas percaktimeve te bera ne udhezuesin kombetar “Administrimi i sigurte i mbetjeve te rrezikshme spitalore”. Terheqja e mbetjeve do te behet sipas nevojave dhe kerkeses se AK –se. Njoftimi behet me sms/email 2 (dy) dite para ne numrin e kontaktit ose adresen e emailit te OE fitues me te cilin do te lidhet kontrata.

3. Të furnizojë me kontenierë AK sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: përmasa që fillon nga 3L deri ne 12 L
- Kontenier plastike të ripërdorshëm të mëdhenj me qese plastmasi njëpërdorimësh për anatomiket 18 01 02 dhe infektivet 18 01 03, të cilët për cdo përdorim duhet ti nënshtorhen pastrimit dhe larjes në makinerinë e posacme të operatorit: përmasa që fillojnë nga 30 L deri ne 60 L

4. Peshimi i mbetjeve do të kryhet nga një peshore e kolauduar nga Drejtoria e Metrologjisë, që do të vihet në dispozicion nga ana e operatorit ekonomik (OE te sjelle dhe certifikaten e kolaudimit te peshores).

5. Pas marrjes në dorëzim të mbetjeve, nga ana e Operatorit Ekonomik do të bëhet dezinfektimi i ambientit nga ku do të tërhiqen mbetjet e rrezikshme spitalore të kontaminuara.

6. Mbetjet e rrezikshme, që dorëzohen nga një person fizik a juridik tek një tjetër, shoqërohen me dokument transferimi, sa herë që do të bëhet evadimi i këtyre mbetjeve.

7. Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Drejtorise se Spitalit me kapacitet 200 - 300 L dhe temperature - 18 C per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit. Pas marrjes se mbetjeve operatori do te beje dezenfektimin e frigoriferit dhe ambientit perreth, si dhe mirembajtjen e frigoriferit.

8. Tek formulari i transferimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore te shenohen dhe kodet perkatese per cdo lloj mbetje :

- | | |
|---------------|---------------|
| - Anatomiket | KODI 18 01 02 |
| - Te mprehtat | KODI 18 01 01 |
| - Infektivet | KODI 18 01 03 |

9. Mbetjet e gjeneruara nga shërbimet do të peshohen në praninë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik dhe përfaqësuesit të AK - se ku do hartohet proces-verbali për sasinë e peshuar, pa përfshirë kutitë e ambalazhimit (pesha e tyre zbritet për kontenieret që janë të riperdorshëm). Ambalazhimi (kontenieret, kutite, qeskat, etj.) do të mbulohen nga subjekti fitues.

10. Autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontratës së lidhur me OE fitues në zbatim të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. Nr.798, datë 29.9.2010 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE” me gjithë ndryshimet KREU V nën titullin “Monitorimi i administrimit të mbetjeve spitalore” ka të drejtë të monitorojë administrimin e mbetjeve spitalore.

Shef/Sek Hoteleri

Martin Zazaj